

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“INRI – M & B ” sh.p.k**

Sot me date 01.09.2023, ne Lezhe ne mbeshtetje te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per shoqerite tregatre”, u hartua ky akt themelim nga ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar:

1. Z. Bledar NDOJ me atesi Pashk, i datelindjes 15.04.1985 lindur ne Lezhe, dhe banues ne Lezhe, me ID personale I50415209D dhe Pasaport Biometrike me nr. BG9924382.
2. Z. Kristian KOLA me atesi Ndue i datelindjes 06.05.1979 lindur ne Spiten, Lezhe dhe banues ne Spiten Lezhe, me ID personale H90506035H dhe Pasaporte Biometrike BC0908402.

Si me poshte vijon :

**Formulimi**

**Neni 1**

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “INRI – M & B ” sh.p.k. Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionit Shqipetar dhe ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

**Selia e Shoqerise**

**Neni 2**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Lezhe, Tresh, Ambjet private ne zonen kadastrale nr.3641, numri i pasurise 15/33.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj vetem me vendim te asamblese se ortakeve.

**Forma e Shoqerise**

**Neni 3**

Forma juridike e shoqerise eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar.

**Objektivi i Veprimtarise**

**Neni 4**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e: Transport mallrash per vete dhe te trete, Siper marrje ndertimi. Import -export mallrave te ndertimit. Tregti artikuj te ndryshem. Punime ne fushen e ndertimit ne zerat: Germime dheu, murature, beton dhe armature, prishje dhe punime ne toke te germuar. Prodhim, grumbullim dhe tregtim materiale inerte dhe gure. Prodhim betoni per ndertim dhe prodhime asfaltike. Prodhim elemente betoni e betonarme te zakvonshme dhe gure decorative. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, mbi 5 kate dhe deri ne 5 kate. Rikonstruksione banesash, ndertime banesa me skelet mbi 8 kate. Ndertim rruge kat.V, VI, III, II e I. Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge dhe ndertim mbi shtresa rrugore. Ndertim ujesjellesa,

kanalizime, kanale e impiante vaditese, Ura e te tjera.

## **Kohezgjatja e Shoqerise**

### **Neni 5**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pa kufizuar (e pacaktuar) duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Me perjashtim te rasteve te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara ne ligj ose me vendim te asamblese se ortakeve.

## **Kapitali i Shoqerise**

### **Neni 6**

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 000 Leke (Njeqindmije) i perbere nga 2 (dy) kuota.

- Bledar NDOJ zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Kristian KOLA zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Shoqeria mund te shtoje ose te zvogeloje kapitalin, ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj, sipas vendimit te asamblese se ortakeve.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i dy ortakeve.

## **Drejtimi i Shoqerise**

*Asambleja e Ortake*

### **Neni 7**

Asambleja e Ortakeve i ushtron te gjitha kompetencat qe i njihen me ligj per shkak te kesaj cilesie.

## **Perfaqesuesi i Shoqerise**

*Administratori*

### **Neni 8**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj z. Bledar NDOJ me atesi Pashk, i datelindjes 15.04.1985 lindur ne Lezhe, dhe banues ne Lezhe, Lagjia Beslidhja, Rruga Fail Konica, me ID personale I50415209D dhe Pasaport Biometrike me nr. BG9924382. Ai eshte perfaqesuesi i shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme.

## **Fitimi**

### **Neni 9**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve te kesaj shoqerie sipas kontributit dhe pjeseve takuese qe kane ne kete shoqeri.

## **Bilanci**

## Neni 10

Viti financiar Fillon me 1 Janar dhe mbaron me 1 Dhjetor te cdo viti.  
Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel miratohen nga asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie.  
Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

## Konfliktet

### Neni 11

Konfliktet qe mund te lindin ndermjet paleve do te gjykohen ne Gjykatën e Shkalles se pare, sipas statutit te shoqerise, kontrates se lidhur ndermjet paleve dhe ne zbatim te legjislacionit Shqiptar.

## Vula dhe shenjat dalluese

### Neni 12

Shoqeria ka vulen dhe shenjat dalluese te saj.


### Neni 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare". Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi marrjes se lejes nga organet kompetente.


### Neni 14

Akti i themelimit u perpilua ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe me vlere te njejte, dhe nenshkruhet rregullisht nga ortaket.

## Asambleja e ortakeve te shoqerise



Bledar NDOJ



Kristian KOLA

